

UDHËZIM
Nr. 12, datë 30.12.2019

**PËR RREGULLAT DHE KRITERET TEKNIKE PËR MIRËMBAJTJEN DHE
FUNKSIONIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE TË KULLIMIT**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 6, të ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi

Përcaktimi i rregullave dhe kriterëve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja në pronësi të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit (DUK) dhe bashkive, apo në përdorim nga organizatat e përdoruesve të ujit (OPU) dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

2. Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja

1.1 Kategoritë e mirëmbajtjes

Mirëmbajtja mund të klasifikohet në 5 kategori kryesore:

- a) rutinë (e përditshme);
- b) periodike;
- c) vjetore;
- d) emergjente;
- e) e diferencuar.

2.1.1 Mirëmbajtja rutinë

Mirëmbajtja rutinë ose e përditshme, përfshin punime të vogla të mirëmbajtjes, që duhen bërë çdo ditë mbi bazën e rregullave të caktuara. Këto punime kryesisht kanë të bëjnë me:

- a) riparime të vogla të bankinave prej dheu në kanale/argjinatura, si pasojë e çarjeve/rrëshqitjeve, erozionit në faqet anësore, të shkaktuara nga rrjedhat e ujërave gjatë reshjeve të shiut, dëmtime nga kafshët, dëmtime nga lëvizjet e njerëzve dhe makinerive të ndryshme, filtrime/rrjedhje të ujit në vrima të vogla;
- b) pastrime të depozitimeve të dherave pranë veprave të artit, veçanërisht te portat, strukturat e komandimit dhe matjes së ujit, sifoneve;
- c) pastrime të mbeturinave, që notojnë në sipërfaqe të ujit, mbeturinave në veprat e artit, skarave metalike, portave;
- d) heqjen dhe prerjen e masës bimore (shkurre, pemë etj.) nga kanalet, argjinaturat dhe rreth veprave të artit;
- e) riparime të vogla në trupin e digës dhe nënobjektet e saj, ujëlëshues dhe shkarkues katastrofik;
- f) grasatimin/vaisjen e nyjave dhe mekanizmave lëvizës (porta, saraçineska, grupe komandimi, reduktorë etj.);
- g) kryerjen e shërbimeve të përditshme në pajisjet elektromekanike të stacioneve të pompimit të kullimit, hidrovore/stacioneve të ujitjes, sipas manualeve të shfrytëzimit;
- h) kryerjen e shërbimeve të përditshme të makinerisë së rëndë ekskavatorë/draga, sipas manualeve të shfrytëzimit.

2.1.2 Mirëmbajtja periodike

Mirëmbajtja periodike, përfshin punime mirëmbajtje të një shkalle të vogël, shpesh parandaluese, që nuk shfaqin ndonjë rrezikshmëri të lartë në funksionimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja. Këto punime mund të kërkojnë

ndërhyrje të specializuara (punime civile) ose makineri, dhe duhet të kryhen në intervale kohore gjatë vitit, siç nevojitet. Këto punime përfshijnë kryesisht:

- a) riparime të veshjeve me beton dhe strukturave përkatëse/veprave të artit;
- b) riparime dhe mirëmbajtje të strukturave prej druri dhe metalike, në veçanti portat;
- c) riparime të strukturave të komandimit dhe matjes së ujit, instrumenteve matës, si dhe veprave të tjera të artit;
- d) riparime në trupin e argjinaturave nëse kanë rrjedhje/filtrime të ujit, ulje të kurorës, kapërdime të ujit etj.;
- e) riparime në trupin e digës dhe nënobjektet të saj, ujëlëshues dhe shkarkues katastrofik (nëse kanë rrjedhje/filtrime të ujit, ulje të kurorës, dëmtime të strukturave prej betoni dhe mekanizmave të komandimit të ujit);
- f) mirëmbajtje të rrugëve të shërbimit/inspektimit;
- g) kryerjen e shërbimeve periodike në pajisjet elektromekanike të stacioneve të pompimit të kullimit hidrovore/stacione të ujitjes (sipas manualeve të shfrytëzimit);
- h) kryerjen e shërbimeve periodike të makinerisë së rëndë ekskavatorë/draga (sipas manualeve të shfrytëzimit).

2.1.3 Mirëmbajtja vjetore

Mirëmbajtja vjetore, përfshin punime të planifikuara si rezultat i inspektimeve/kontrolleve të kryera më parë, të cilat janë të konsiderueshme (punime të mëdha dhe që kërkojnë kohë për t'u realizuar), që nuk mund të kryhen si punime të mirëmbajtjes periodike.

Këto punime duhet të kryen në periudhat e përshtatshme, kur infrastruktura e ujitjes, kullimit, digat dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja nuk janë në përdorim/shfrytëzim. Në këto punime përfshihen kryesisht:

- a) largimi i sasive të mëdha të mbushjeve në kanalet ujitës, kullues dhe kanale të ujërave të larta;
- b) riparime të veshjeve me beton në kanalet ujitës, kullues dhe kanale të ujërave të larta;
- c) riparime të strukturave prej betoni dhe metalike të veprave të artit në rrjetin e kanaleve ujitës e kullues;
- d) riparime të trupit të argjinaturave, mirëmbajtje e drenazheve, si dhe riparime e mirëmbajtje të rrugëve të shërbimit;
- e) riparime në trupin e digës dhe nënobjektet e saj (riparime të planifikuara pas inspektimeve teknike dhe preventivimit të zërave të punimeve), që lidhen me riparime në trupin e digës, pastrime dhe riparime të shkarkuesit katastrofik, riparime të ujëlëshuesit, mekanizmave të komandimit të ujit, saraçineska, porta, mekanizmat e ngritjes, rrugëve të shërbimit etj.;
- f) riparime/zëvendësime, të pajisjeve, portave dhe mekanizmave ngritës;
- g) riparime/zëvendësime, të pajisjeve elektromekanike të stacioneve të pompimit të kullimit hidrovore/stacioneve të pompimit të ujitjes (pompa, elektromotorë, pajisjet elektrike të lëshimit të elektropompave, skarave dhe mekanizmave të pastrimit të skarave etj.).

2.1.4 Mirëmbajtja emergjente

2.1.4.1 Mirëmbajtja emergjente, ka të bëjë me punime, që nuk mund të planifikohen dhe duhet të kryhen kur del e nevojshme. Përballja me problematika të tilla, që nuk mund t'i përcaktosh se kur mund të ndodhin dhe çfarë natyre do të kenë, krijon vështirësi, gjë për të cilën është e nevojshme të ketë fleksibilitet në praktikat e kryerjes së punimeve të ndryshme. Punimet në këtë kategori mund të jenë:

- a) riparime të përkohshme, si pasojë e reshjeve intensive apo përmbytjeve;
- b) riparime të përkohshme, si rezultat i prishjes së strukturave/pajisjeve/mekanizmave (struktura prej dheu, betoni, pajisje dhe mekanizma elektromekanik etj.);
- c) riparime të përkohshme nga veprime të paparashikuara (tërmete, dëmtime të qëllimshme etj.);

d) punime emergjente për rritjen e qëndrueshmërisë/sigurisë së argjinaturave mbrojtëse, digave, kanaleve të ujërave të larta etj., në raste të rrezikimit të tyre nga kapërdimi i ujit mbi to nga prurjet e mëdha të ujit etj.

2.1.4.2 Punimet emergjente për vetë rëndësinë që kanë, duhet të kryhen shpejt, pasi veprimet e menjëhershme minimizojnë zgjerimin e dëmtimeve, gjë për të cilën kërkohet të kryhen këto punime riparuese.

2.1.4.3 Në situata emergjente, komunikimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm (që kanë të bëjnë me paralajmërimin, operimin dhe mirëmbajtjen), është i domosdoshëm për veprim të shpejtë dhe minimizim të dëmeve në infrastrukturë dhe në palët e treta, që afektohen nga përmbytjet.

2.1.5 Mirëmbajtja e diferencuar

2.1.5.1 Mirëmbajtja e diferencuar, apo në pritje të krijimit të kushteve për t'u realizuar, ka të bëjë me ndërhyrje të identifikuar gjatë inspektimeve teknike të infrastrukturës, por realizimi i tyre është i një prioriteti të ulët (pret në kohë) dhe mundësitë financiare për ta kryer këtë ndërhyrje nuk janë të mjaftueshme. Këto punime regjistrohen si mirëmbajtje e mundshme, dhe kohë pas kohe shikohet mundësia e realizimit të tyre.

2.1.5.2 Disa nga punimet në këtë mirëmbajtje kanë të bëjnë me përmirësime/rritje të mëtejshme të sigurisë së strukturave të ndryshme (trupi i argjinaturës, digës), si dhe përmirësime të aksesit për të operuar në infrastrukturë (rrugët e shërbimit në argjinatura, rrugët që të çojnë në diga etj.)

2.2 Cikli i mirëmbajtjes:

Cikli i mirëmbajtjes përbëhet nga:

- a) inspektimi i infrastrukturës/objekteve;
- b) matje e volumit të punimeve;
- c) preventivimi/kostimi i punimeve;
- d) përcaktimi i buxhetit;
- e) prioritetizimi i ndërhyrjeve të mirëmbajtjes;
- f) planifikimi i ndërhyrjeve prioritare për buxhetin disponibël;
- g) kontraktimi;
- h) kryerja e punimeve;
- i) mbikëqyrja e realizimit të punimeve;
- j) kolaudimi dhe marrja në dorëzim;
- k) pagimi i punimeve të kryera.

2.3 Organizimi i inspektimeve/kontrolleve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

2.3.1 Përveç kontrolleve të përditshme dhe në raste të emergjencave, gjatë një viti duhet të kryhen së paku dy kontrolle të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja.

i. Një kontroll kryhet në periudhën mars–prill, pas sezonit me reshje dhe para fillimit të sezonit të ujitjes.

ii. Ndërsa kontrolli tjetër kryhet në periudhën shtator–tetor, para fillimit të sezonit me reshje dhe pas përfundimit të sezonit të ujitjes.

2.3.2 Në kontrollin e periudhës mars–prill

2.3.2.1 Në ujitje:

a) kontrollon gjendja e infrastrukturës së ujitjes para sezonit të ujitjes (rrjeti i kanaleve ujitës, veprat e marrjes së ujit, veprat e artit, stacionet e pompimit të ujitjes etj.), punimet e realizuara dhe ndërhyrjet, që mund të realizohen deri në fillimin e ujitjes;

b) kontrollon gjendja teknike e digave dhe funksionaliteti i ujëlëshuesve, si dhe sasia e ujit në rezervuarë, disponibël për sezonin ujitës;

c) mblidhet informacioni i nevojshëm mbi sipërfaqet e mbjella (ose që pritet të mbillen), si dhe llojin e kulturave bujqësore, dhe hartohet paraprakisht grafiku (programi) i ujitjes për çdo burim ujqor (skemë ujitëse etj.).

2.3.2.2 Në kullim dhe mbrojtje nga përmbytja:

a) kontrollohen kanalet kulluese, kanalet e ujërave të larta dhe argjinaturat e mbrojtjes nga përmbytja, duke vlerësuar ndërhyrjet riparuese të parashikuara për t'u realizuar, si dhe vlerësimin e punimeve të tjera të parashikuara por, që janë të domosdoshme në momentin e mbikëqyrjes dhe që duhen kryer para fillimit të sezonit me reshje (para muajit tetor);

b) vlerësohen paraprakisht nevojat për remontin vjetor të hidrovoreve, që kryhet në periudhën pa reshje (zakonisht korrik–gusht);

c) bëhet kontrolli i portbarazheve për pozicionimin e duhur të portave.

2.3.3 Në kontrollin e periudhës shtator-tetor

2.3.3.1 Në ujitje:

a) kontrollohen veprat e marrjes së ujit për ujitje nga lumenjtë dhe kryerja e veprimeve përkatëse për periudhën në vijim (vjeshtë–dimër);

b) kontrollohet gjendja teknike e digave të rezervuarëve, të cilat duhet të jenë në gatishmëri të plotë brenda datës 30 shtator (para kësaj date, në digë duhet të jenë kryer të gjitha ndërhyrjet e nevojshme rehabilituese dhe mirëmbajtëse për të pasur në gjendje të mirë trupin e digës, shkarkuesin katastrofik dhe ujëlëshuesin, si dhe gjendja teknike e ushqyesve të rezervuarëve);

c) bëhet kontrolli i portbarazheve për pozicionimin e duhur të portave.

2.3.3.2 Në kullim dhe mbrojtje nga përmbytja:

a) kontrollohen punimet e kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, kanaleve të ujërave të larta, argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytja;

b) kontrollohet kryerja e remonteve të hidrovoreve dhe bëhet testimi me ngarkesë i tyre (mbahet aktkolaudimi përkatës për çdo elektropompë dhe pajisje elektrike);

c) vlerësohet mundësia e realizimit të ndonjë ndërhyrje për periudhën në vijim, që nuk ka qenë e parashikuar por që ka dalë gjatë kontrollit.

d) kontrolli, duhet të garantojë qëndrueshmërinë e plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionalitetin e infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje.

2.4 Rehabilitimi

Rehabilitimi/rikonstruksioni i infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe digave, ka për qëllim rikthimin e veprave ekzistuese në kushtet e projektit fillestar, shoqëruar me përmirësime të treguesve teknik dhe të modernizmit të funksionimit të tyre.

Rehabilitimet/rikonstruksionet apo ndërtimet e reja realizohen nëpërmjet projekteve të investimeve.

2.5 Standardi

Implementimi i projekteve të mirëmbajtjes me shpenzime dhe projekteve të rehabilitimit /rikonstruksionit/ndërtimit, me investime, të objekteve/veprave të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, në të gjitha fazat e ciklit (studim, detyrë projektimi, projekt ide, projekt zbatim, zbatim i punimeve, mbikëqyrja, kolaudimi dhe marrja në zbatim), si dhe shfrytëzimi i kësaj infrastrukture, të bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për punimet e ndërtimit, për sigurinë e digave, për kriteret teknike të projektimit të veprave ujore (veprave të ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtje nga përmbytja) etj.

3. Dokumentacioni teknik

a) Për çdo vepër hidroteknike (ndërtim hidroteknik) mbahet (ndër të tjera) dokumentacioni teknik si më poshtë:

b) projekti i plotë i veprës bashkë me ndryshimet, që mund të jenë bërë gjatë zbatimit;

c) preventivat dhe situacioni përfundimtar;

d) akti i marrjes në dorëzim së bashku me aktet e kontrollit dhe procesverbalet e bëra gjatë ndërtimit të veprës;

e) të dhëna të vrojtimit të ndryshme, si për nivelet e ujit, reperet e cedimit etj.;

f) dokumentet teknike për riparimet, përforcimet dhe rikonstruksionet/rehabilitimet e bëra në vepër etj.;

g) libri i veprës në të cilin shënohen kontrollet e bëra, detyrat që lihen dhe zbatimi i tyre, dëmtimet, riparimet, si dhe çdo gjë tjetër, që paraqet interes, si kalimi i prurjeve të jashtëzakonshme etj.;

h) Planimetritë më shkallë jo më të vogël se 1: 10 000, në të cilat veprat e artit shënohen me shenjë konvencionale. Këto vepra pasqyrohen edhe në profilet e kanaleve përkatës.

4. Afatet e vënies në gatishmëri të infrastrukturës

4.1 Afatet e vënies në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja janë:

a) digat e ujëmbledhësve (rezervuarëve)	30 shtator
b) kanalet ujitëse, stacionet ujitës dhe veprat e artit në këto kanale:	
i. në zonën fushore	15 prill
ii. në zonën kodrinore malore	30 prill
c) kanalet kulluese, KUL dhe veprat e artit në këto kanale	30 tetor
d) argjinatura/pendët e lumenjve	30 shtator
e) stacionet e pompimit të kullimit-hidrovore	30 shtator

4.2 Me gatishmëri të:

a) digave të ujëmbledhësve deri në 30 shtator, kuptohet vënia në gjendje teknike sipas projektit e trupit të digave, ujëlëshuesit, saraçineskave, shkarkuesit katastrofik, kanaleve ushqyes etj. Mund të vazhdojnë deri në 30 tetor punimet për gatishmërinë e shkarkuesve, stacioneve të pompimit e kanaleve ushqyes, si dhe riparime të tjera, që nuk prekin qëndrueshmërinë e trupit të digës dhe mbushjen me ujë të ujëmbledhësit. Bëjnë përjashtim këtu ujëmbledhësit, që sipas projektit e fillojnë mbushjen me ujë në afate të tjera;

b) kanaleve ujitës e kullues dhe kanaleve të ujërave të larta, kuptohet sjellja e seksionit të kanaleve dhe bankinave në përmasat e projektit dhe riparimin e veprave të artit në këto kanale;

c) stacioneve të pompimit për ujitje dhe kullim (hidrovore), kuptohet kryerja e të gjitha riparimeve/shërbimeve dhe kontrolleve përkatëse të pajisjeve elektromekanike, si dhe testimi i tyre me ngarkesë të plotë (kolaudimi përfundimtar);

d) argjinaturave/pendëve të lumenjve, kuptohet sjellja e tyre në përmasat e projektit dhe riparimin e veprave të artit në to.

5. Zonat e shërbimit

Zonat nën ujitje dhe kullim, si dhe të mbrojtjes nga përmbytja në administrim të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe OPU-ve, përcaktohen sipas regjistrave përkatës të miratuar me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Detyrat e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit/Bashkisë, brenda zonës së vet të shërbimit janë:

6.1 Vënia në gatishmëri e infrastrukturës ujitëse, kulluese, hidrovoreve, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, sipas afateve të përcaktuara në pikën 4, të këtij udhëzimi;

6.2 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt, të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe parandalimit të përmbytjes;

6.3 Me fondet vjetore (shpenzime dhe investime), të planifikuara për infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, në administrim:

a) pastron dhe mirëmban kanalet ujitëse dhe kulluese, si dhe veprat e artit;

b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe kullimit;

c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja;

d) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe kur është e nevojshme kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimin për garantimin e sigurisë së tyre;

e) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;

f) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet;
g) përmbush detyrat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore;

h) monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.

6.4 Hartimi i grafikëve të ujitjes dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse të menaxhimit të burimeve ujore, për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, në mënyrë të tillë, që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar.

6.5 Kryerja e kontrolleve teknike të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe ndërmerrja e veprimeve përkatëse për ruajtjen e sigurisë dhe sjelljen e tyre në kushtet e projektit, si më poshtë:

6.5.1 Për digat e ujëmbledhësve (rezervuarëve):

Përveç mbikëqyrjes së zakonshme gjatë shfrytëzimit të veprës dhe detyrimeve, që rrjedhin nga ligji nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” dhe udhëzimeve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, kryhen veprimet si më poshtë:

6.5.1.1 Kontrollohet kurora e digës;

6.5.1.2 Kontrollohet gjendja e shpatinave, veshjet e saj dhe masa të tjera për mbrojtjen nga gërryerja;

6.5.1.3 Kontrollohet gjendja e shkarkuesit katastrofik, ujëlëshuesit, saraçineskave, portave, drenazheve etj.;

6.5.1.4 Vërehet nëse ka në trupin e digës dhe në terrenin përreth shenja plasaritjesh, filtrimesh, shkarjesh etj.;

6.5.1.5 Hartohet plani i alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave;

6.5.1.6 Monitorohen digat e rezervuarëve nga njësia e drejtimit teknik të DUK/Bashkisë, e cila:

6.5.1.6.1 Merr masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të shfrytëzimit të digave për mbikëqyrjet, vrojtimet, matjet, përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre;

6.5.1.6.2 Merr masa për sigurimin e menjëhershëm të projekteve të zbatimit për ndërtimin e digave dhe hedhjen e të dhënave teknike në regjistrin përkatës të çdo dige, kryesisht për këto element:

a) trupi i digës;

b) drenazhet;

c) bazamenti;

d) skarpatet;

e) kurora e digës;

f) elementet e papërshkueshmërisë;

g) vëllimi i vdekur;

h) vëllimi i shfrytëzueshëm;

i) vëllimi i përpunimit;

j) rezerva nga niveli maksimal deri në kurorë;

k) brigjet që e rrethojnë atë;

l) sistemet e devijimit;

m) sistemet e shkarkimit;

n) sistemet e marrjes;

o) sistemet e zbrazjes;

p) sistemet e furnizimit;

q) godina e shërbimit dhe ruajtjes.

6.5.1.6.3 Për mirëfungsionimin e elementeve të mësipërm të digës, bën vizita periodike vizuale në objekt dhe ambientet rreth tij (kontroll i gjendjes së sistemeve të shkarkimit, zbrazjes dhe marrjes së ujit, si dhe zonave të paqëndrueshme në brigjet e ujëmbledhësit), në lidhje me:

- a) kontrollin e kurorës së digës, nëse ka ulje, deformime, mbirje pemësh;
- b) kontrollin e skarpatit të anës së sipërme (sidomos kur ulet niveli i ujit në ujëmbledhës) nëse ka dëmtime të skarpatit, zhvendosje të veshjes mbrojtëse, mbirje pemësh;
- c) kontrollin e skarpatit të anës së poshtme, nëse ka rrjedhje uji, dëmtime të skarpatit, fole kafshësh, mbirje pemësh;
- d) kontrollin e shkarkuesit, nëse ka bllokime apo ngushtim seksioni nga materiale të ndryshme, erozioni, korrozioni;
- e) kontrollin e shuarësit të energjisë, nëse ka gërryerje apo deformime të ndryshme;
- f) kontrollin e kontaktit të digës me brigjet, nëse ka rrjedhje, erozion;
- g) kontrollin e qëndrueshmërisë së brigjeve të ujëmbledhësit, nëse ka rrëshqitje, erozion;
- h) kontrollin e aftësisë tërheqëse të prurjes maksimale në anën e poshtme të digës, nëse ka ngushtime seksioni, rrëshqitje, ndërtime të pa kontrolluara;
- i) kontrollin nëpërmjet matjeve të aparaturave të vendosura në objektet dhe nënobjektet sipas projektit;
- j) hartimin e raportit për mirëmbajtjen dhe eliminimin e dëmtimeve të vogla, grafikët e matjeve, rezultatet e interpretimeve.

6.5.1.7 Në fund të çdo muaji për të gjitha kontrollet e ushtruara në diga, përpilohet proces verbali për çdo objekt, ku paraqitet gjendja sipas sistemeve të kontrolluara si më sipër, dhe i bëhen prezent eprorit përkatës, i cili informon drejtuesin e institucionit;

6.5.1.8 Në mënyrë të vazhdueshme, harton dhe plotëson regjistrin për mbikëqyrjet, vrojtimit, matjet, përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre, duke shënuar në këtë regjistër sipas datave, ngjarjet gjatë shfrytëzimit të objektit dhe ujëmbledhësit, si mbushjet, zbrazjet, shkarkimet, manovrimet e portave, matjet, kontrollet, incidentet, që konstatohen (filtrime, rrjedhje uji, plasaritje etj.), ngjarjet hidrometeorologjike të veçanta, lëkundjet sizmike dhe pasojat e tyre, punimet e mirëmbajtjes, përmirësimet dhe riparimet e kryera në objekt, si dhe çdo gjë tjetër, që duhet të regjistrohet;

6.5.1.9 Të marrë masa, që për çdo ndryshim, që bëhet në legjislacionin dhe në rregulloret e miratuara nga organet shtetërore, të reflektohen në rregullat teknike të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të digave dhe nënobjekteve të digave;

6.5.1.10 Të marrë masa, që para fillimit të çdo sezoni të shkarkimeve, të kontrollohet funksionimi i të gjitha nënobjekteve të shkarkimit e të boshatisjes së ujëmbledhësit, deri në vendet ku shuhen efektet e shkarkimeve, duke marrë masat përkatëse për mangësitë, që konstatohen, me afate të përcaktuara për vënien në gatishmëri të plotë të tyre;

6.5.1.11 Kontrollon tri herë në vit pjesën e poshtme të rrjedhës, në raste të konstatimit të pengesave të shkarkimeve, merr masat e duhura për një shkarkim normal;

6.5.1.12 Bën regjistrimin e niveleve të ujit në ujëmbledhës, prurjet e lumit, që ushqejnë ujëmbledhësin, shkarkimet, duke bërë dhe krahasimet me të dhënat në projekt;

6.5.1.13 Harton preventivat për nevoja me bazë materiale dhe shpenzime për mirëmbajtjen;

6.5.1.14 Mbi bazën e kontrolleve, vrojtimeve, nxjerr konkluzione për gjendjen teknike të digave, si dhe propozon masa për ndërhyrje, për kryerjen e investimeve.

6.5.2 Për digat mufatëse në shtratin e lumenjve:

6.5.2.1 Nivelohen pikat karakteristike për të parë a ka cedime;

6.5.2.2 Nivelohet profili tërthor i shtratit të lumit para dhe pas veprës për të parë a ka gërryerje;

6.5.2.3 Vërehet a ka dëmtime, shkarje, filtrime, gërryerje etj.;

6.5.2.4 Kontrollohen pjesët prej betoni ose guri të mbuluara me ujë për të parë a ka gërryerje apo dëmtime;

6.5.2.5 Kontrollohet funksionimi i portave e mekanizmave të lëshimit të ujit;

6.5.3 Për veprat e mbrojtjes nga përmbytja:

6.5.3.1 Kontrolli dhe mirëmbajtja e veprave të mbrojtjes nga përmbytja, argjinaturave/pendëve, duhet të garantojë mbrojtjen e tyre nga dëmtimet, mbajtjen në gatishmëri të plotë për të përballuar prurjet e parashikuara në projektet përkatëse dhe pas çdo dëmtimi, sa do të vogël, rivendosjen me rreptësi të kushteve të projektit, duke i konsideruar këto veprime si një minimum i domosdoshëm, dhe në përputhje me këtë, DUK/bashkia, duhet të:

- a) Kontrollon argjinaturat/pendët, në çdo kohë në lidhje me shkarjet, gërryerjet, uljet e kurorës, vrimat që hapen nga kafshët, bimësinë, plasaritjet tërthore e gjatësore;
- b) Sigurojë ruajtjen e argjinaturave nga dëmtimet;
- c) Sigurojë ndreqjen e dëmtimeve, që pësojnë argjinaturat/pendët për shkaqe të ndryshme;
- d) Sigurojë, që sopi (toka midis shtratin të lumit dhe argjinaturës/pendës) të ruhet gjithnjë e lirë dhe pa pengesa, sipas parashikimit të projektit dhe të mos hapen në të, rrjedhje të reja uji;
- e) Mirëmbajë veprat e ndërtuara në shtratin e lumit për mbrojtjen e brigjeve nga gërryerjet (pendë tërthore, veshje etj.) dhe kryen punime të tilla kur paraqitetet nevoja;
- f) Vendosë reperat e kuotave, gurët kilometrik, lata hidrometrike, shenjat e niveleve karakteristike, mbajtjen në rregull dhe vazhdimisht të azhurnuar të dokumentacionit teknik të argjinaturave/pendëve, që administron;
- g) Mirëmbajë rrugët e shërbimit të pendeve dhe argjinaturave;
- h) Përpunojë në kushtet konkrete të argjinaturave/pendëve të ndryshme, përvojën, që krijohet gjatë mirëmbajtjes, të kalimit të plotave dhe në përputhje me këtë, të përcaktojë dhe zbatojë masat përkatëse dhe bëjnë e propozimeve që shihen të nevojshme;
- i) Ndalojë kalimet e automjeteve, mekanizmave të ndryshme mbi argjinaturat, me përjashtim të rasteve kur në projekt parashikohet, që këto të shërbejnë edhe si rrugë e mjeteve, që punojnë për mirëmbajtjen dhe riparimin e vetë argjinaturës/pendës;
- j) Lejojë kalimin e automjeteve, mekanizmave dhe bagëtive, tërthor argjinaturave /pendëve, vetëm në vende kalimi të posaçme të përcaktuara në projekt;
- k) Mbillen breza pyjorë, për mbrojtjen e pendëve nga ana e jashtme, jo më afër se 4 metra nga rrëza e brinjës së argjinaturës/pendës;
- l) Ndalojë mbjelljen e çdo lloji druri në trupin e argjinaturave/pendëve dhe në brezin 4 metër të gjerë të matur nga rrëza e brinjës së argjinaturave/pendëve nga ana e ujit;
- m) Bëjë njoftimin mbi nivelet dhe prurjet e ujit gjatë kalimit të prurjeve të mëdha të lumenjve, referuar treguesve të pikave hidrometrike;
- n) Mbikëqyrë nivelet e ujit gjatë kalimit të plotave të mëdha të lumenjve për të përcaktuar nivelin e rrezikut për të cilën fillon monitorimi dinamik, si dhe për të marrë masat përkatëse në zonën e rrezikuar.

6.5.4 Për kanalet ujitës, kullues dhe KUL, kryhet kontrolli:

- a) nga mbushjet me sedimentet;
- b) nga bimësia;
- c) skarpateve/bankinave;
- d) veshjeve me beton;
- e) veprave të artit, dëmtimet/çarjet e betonit;
- f) portave (grupet e komandimit, korniza udhëzuese e portës, porta me strukturat përforcuese dhe gominat hermetizuese) etj.

6.5.5 Për stacionet e pompimit të kullimit (hidrovoret):

6.5.5.1 Kontrollon gjendja e ndërtesës së hidrovorit (vaskat në hyrje dhe në dalje, skarat metalike, bazamentet ku bazohen pompat, kolonat, trarët e lëvizjes së vinçit, mbulesa e sipërme, cedime në strukturën ndërtimore etj.);

6.5.5.2 Kontrollon gatishmëria teknike e elektromotorëve, pompave, pajisjeve elektrike të lëshimit, transformatorët, siguresat dhe çelësat e tensionit të mesëm dhe të ulët, tokëzimi etj.;

6.5.5.3 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e hidrovoreve bëhet sipas përcaktimeve të pikës 12, të këtij udhëzimi.

6.5.6 Për stacionet e pompimit të ujitjes:

6.5.6.1 Kontrollohet gjendja e ndërtesës (vaskat në hyrje dhe në dalje, tubacioneve të thithjes dhe dërgimit, skarat metalike, bazamentet ku bazohen pompat, kolonat, trarët e lëvizjes së vinçit, mbulesa e sipërme, cedime në strukturën ndërtimore etj.);

6.5.6.2 Kontrollohet gatishmëria teknike e elektromotorrëve, pompave, pajisjeve elektrike të lëshimit, transformatorët, siguresat dhe çelësat e tensionit të mesëm dhe të ulët, tokëzimi etj.;

6.5.6.3 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të pompimit të ujitjes, bëhet në analogji me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrovoreve.

6.5.7 Për makinerinë e rëndë (ekskavatorë dhe draga) dhe mjetet e transportit

Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i makinerisë së rëndë, mjeteve të transportit, bëhet sipas përcaktimeve të pikës 13 të këtij udhëzimi.

6.6 Në përfundim të çdo kontrolli të veprave të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, hartohet aktkontrolli nga grupi, që kryen kontrollin duke përcaktuar gjendjen, masat dhe afatet e kryerjes së punimeve. Aktkontrolli i dorëzohet eprorit përkatës.

6.7 Për gjendjen teknike të trupit të digës së ujëmbledhësit dhe punimet, që do të kryhen për gatishmërinë dhe plotësimin me ujë të tij, si dhe data e mbylljes së ujëlëshuesit, mbahet një proces- verbal tip, i miratuar nga eprori përkatës.

6.8 Për çdo rast të dëmtimeve që rrezikojnë qëndrueshmërinë e veprës ose shfrytëzimin e saj, si dhe pas ngjarjeve të jashtëzakonshme si kalim prurjesh të mëdha, përcaktohen kontrolle teknike dhe masat që duhet të merren.

6.9 Mban regjistrat e miratuar me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Shfrytëzimi i veprave ujitëse

7.1 Plotësimi me ujë i ujëmbledhësve bëhet sipas parashikimeve në projektin e veprës, ndërsa data e mbylljes së saraçineskave ose portave të ujëmbledhësit caktohet me shkrim nga eprori përkatës.

7.2 Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit/Bashkia/OPU-ja, mban të dhëna periodike mbi plotësimin me ujë të ujëmbledhësve në regjistra shumëvjeçarë. Koha e regjistrimit të niveleve gjatë plotësimit të periudhës me ujë, caktohet nga eprori përkatës sipas madhësisë së veprës dhe karakterit të pellgut ujëmbledhës.

7.3 Shfrytëzimi i veprave ujitëse ose kulluese, bëhet për sipërfaqet e tokave bujqësore të përcaktuara nga projekti.

7.4 Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, bën shpërndarjen e prurjeve të ujit vetëm në pikat e marrjes së ujit, që janë në kanalet ujitëse kryesore në administrim të saj, ndërsa bashkitë/OPU-të, në pikat në administrim të tyre.

7.5 Shpërndarja e ujit në kanalet e veprat ujitëse, bëhet me vepra matëse ose sipas parashikimit të përbashkët (DUK-Bashki-OPU), për veprat e përbashkëta.

7.6 Dhënia e sasive të ujit, nga veprat ujitëse në administrim të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit për Bashkinë, bëhet me kontratë, e cila hartohet sipas rezervave ujore të veprës ujitëse dhe aftësisë përcjellëse të projektuar të rrjetit ujitës. Zbatimi i kontratës bëhet mbështetur në kërkesat dhe dorëzimet, çdo 5 ditë, gjatë gjithë periudhës së ujitjes.

7.7 Humbjet e ujit për filtrim dhe avullim, llogariten për gjatësitë e kanaleve ujitës, që mirëmbahen dhe vihen në gatishmëri nga vetë Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit/Bashkia.

7.8 Në rastet, kur për shkak të mungesës së reshjeve, ujëmbledhësit nuk janë plotësuar me ujë ose janë pakësuar prurjet e lumenjve etj., shpërndarja e ujit për bashkitë/OPU-të (për veprat ujitëse në administrim të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit/Bashkisë), bëhet proporcionalisht, sipas sipërfaqeve e normave ujitëse të bimëve bujqësore, që kërkojnë ujitje.

8. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural krijon dhe mban regjistrin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave të përdoruesve të ujit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

9. Organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sigurinë e digave dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja

9.1 Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, këto struktura përbëhen nga katër drejtori të ujitjes dhe të kullimit, Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë, të krijuara me VKM-në nr. 437, datë 17.5.2017, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”.

9.2 Funksionimi i drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit bazohet në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit”, të miratuar nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

9.3 Për bashkitë:

a) çdo bashki duhet të ketë njësinë përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin, për përmbytjen e detyrimeve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) organizimi/struktura dhe rregullat e funksionimit të njësisë përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin të bashkisë (NJPUKB), duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak.

10. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, mund të nxjerrin rregullore /udhëzime të brendshme specifike, me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, por pa rënë në kundërshtim me këtë udhëzim dhe legjislacionin në fuqi.

11. Rregullat dhe kriteret teknike, sipas këtij udhëzimi, vlejné edhe për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe digave, të transferuara në përdorim të organizatave të përdoruesve të ujit dhe shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

12. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të pompimit të kullimit-hidrovoreve

12.1 Të përgjithshme

12.1.1 Shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe sigurimi teknik e mbrojtja në punë në hidrovore, për veç sa përcaktohet në manualët teknike të shfrytëzimit të pajisjeve elektrike dhe mekanike të instaluar në hidrovore, akteve ligjore e nënligjore në fuqi, bazohet në respektimin e rregullave dhe kriterëve teknike, sipas pikës 12 të këtij udhëzimi.

12.1.2 Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, janë përgjegjës për zbatimin e këtyre rregullave teknike, për shfrytëzimin në parametra normal, të sigurt e me efikasitet të hidrovoreve.

12.1.3 Çdo punonjës i shfrytëzimit të hidrovorit, për çdo parregullsi, në të gjitha rastet, duhet të marrë masat e nevojshme për eliminimin e tyre dhe në pamundësi të kësaj, është i detyruar të njoftojë përgjegjësën nga varet ose përgjegjësën më të lartë.

12.1.4 Punonjësi i shfrytëzimit të hidrovorit duhet të plotësojë këto kusht:

a) të ketë arsimin e mesëm elektrik/mekanik ose të përgjithshëm. Për rastin e arsimit të përgjithshëm, duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të aftësisë profesionale (jo më pak se 6-mujore), për profesionin elektrikist apo mekanik;

b) të ketë librezën e instruktimit të sigurimit teknik, minimalisht të grupit të tretë të sigurimit teknik.

12.1.5 Çdo punonjës i ri duhet të mësojë më parë rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes në punë, rregullat për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrovorit dhe t'i zbatojë ato nën drejtuesin e një punonjësi me përvojë pune mbi 3 vjet, si punonjës hidrovori, për një periudhë prove prej 3 muaj.

12.1.6 Në hidrovore duhet të krijohen kushte normale pune:

a) hidrovoret të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, mjete matëse, vegla pune, ambiente hidrosanitare etj.;

b) reparti i elektropompave:

i. të jetë i pajisur me mjete mbrojtëse izoluese, si: doreza dielektrike, shtagë, galloshe mbështetëse, tapet gome përreth paneleve elektrike etj.;

ii. të ketë në vende të dukshme shënimet paralajmëruese të sigurimit teknik, që lexohen qartë si: “Tension i lartë”, “Mos prek, tension i lartë” etj., ndërsa në periudhën e remontit vendosen

shënimet e përkohshme paralajmëruese si: “Mos kyç, bëhet remont”, “Mos kyç, punojnë punonjësit” etj.;

iii. të këtë ndriçim normal, si dhe të vendoset ndriçimi portativ me burim tensioni 12 volt, 24 volt, 36 volt, i cili përdoret kur ndërpritet energjia elektrike.

12.2 Sigurimi teknik e mbrojtja në punë në hidrovor

12.2.1 Punonjësit e shfrytëzimit të hidrovoreve instruktohen dhe kalojnë në testim për njohuritë e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë, siç e përcakton legjislacioni në fuqi.

12.2.2 Punonjësi i shfrytëzimit të hidrovorit duhet të këtë minimum, grupin e tretë të sigurimit teknik dhe të jetë i pajisur me dokumentacionin përkatës, që lëshohet për këtë qëllim.

12.2.3 Me urdhër të drejtorit të drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit/ drejtuesit të NJPUKB-së, caktohet një punonjës (inxhinier elektrik/mekanik), që njëherë në tre muaj të instruktojë (kontrollojë njohuritë) punonjësit e hidrovoreve mbi zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë. Ky proces pasqyrohet në regjistrin përkatës të aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

12.2.4 Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, janë përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në hidrovor dhe marrjen e masave përkatëse për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga këto rregulla.

12.3 Rregullat e brendshme në hidrovor

12.3.1 Repartet/ambientet e brendshme në hidrovor, të jenë në çdo kohë të pastër e të sistemuar, dhe për çdo gjë duhet të këtë një vend të përcaktuar qartësisht.

12.3.2 Territori i jashtëm i hidrovorit të jetë i rrethuar, me portë hyrëse të madhe e të sigurt, i sistemuar e gjelbëruar dhe i ndriçuar nga të gjitha anët.

12.3.3 Fasadat e jashtme dhe ambientet e brendshme, të jenë të pastra dhe mundësisht të lyhen një herë në dy vjet.

12.3.4 Në një vend të dukshëm, në hyrje të hidrovorit, të vendoset hidrometri i vijëzuar me kuota referuese për nivelet e ujit, sipas të cilave përcaktohen, ndër të tjera, niveli kritik paralajmërues, niveli ku fillon dalja e ujit në sipërfaqen e tokës (fillimi i përmytjes) dhe niveli më i ulët ujit, ku duhet të stakohen (dalin nga puna) elektropompat.

12.3.5 Hidrovoret, duhet të kenë në çdo kohë një komunikim të sigurt me, nënstationet elektrike, që furnizojnë hidrovoret me energji elektrike, njësitë administrative, DUK/bashkitë, emergjencat civile etj.

12.3.6 Kyçja dhe hapja e thikave me shtagë izoluese, si dhe kyçja dhe hapja e çelësave me komandim me dorë, duhet të bëhet me doreza dielektrike, por gjithmonë pasi të jeni siguruar më parë, që keni shkyçur elektropompat apo ndonjë ngarkesë tjetër.

12.3.7 Vendosja dhe heqja e siguresave në impiantet elektrike me tension mbi 1000 volt, bëhet me anën e darëve izolues, duke përdorur doreza dielektrike, syze dhe duke qëndruar mbi një shtresë izoluese.

12.3.8 Remonti i pajisjeve elektrike, makinerive elektrike, paneleve elektrike etj. të tensionit të ulët, fillon vetëm pasi të jetë siguruar mungesa e energjisë elektrike, duke marrë ndër të tjera, këto masa:

- a) të jenë hapur linjat ushqyese;
- b) të jenë hequr siguresat;
- c) të jetë provuar mungesa e tensionit me tregues tensioni ose llambë;
- d) të jetë bërë tokëzimi portativ dhe lidhja në të shkurtër e linjës ushqyese me pajisjen elektrike, që do t'i bëhet remonti;
- e) të jenë vendosur shënimet paralajmëruese përkatëse.

12.3.9 Çdo hidrovor duhet të këtë personel shfrytëzimi (2 punonjës në çdo ndërrese dhe 3 ndërresa në 24 orë), të miratuara nga drejtori i Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit/ drejtuesi i NJPUKB-së.

12.3.10 Punonjësit e ndërresës duhet të punojnë sipas një grafiku të miratuar dhe zëvendësimi i një punonjësi të ndërresës me një punonjës tjetër, lejohet vetëm me urdhër të drejtorit të DUK/drejtuës të NJPUKB-së.

12.3.11 Çdo punonjës ndërrese, kur vjen në punë, duhet të marrë në dorëzim ndërresën nga punonjësi i ndërresës së mëparshme siç përcaktohet në regjistrin përkatës të aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

12.3.12 Në çdo hidrovor, në repartin e elektropompave, duhet të jenë vendosur në kornizë me xham, në një vend të dukshëm:

- a) skema elektrike principale e furnizimit dhe shpërndarjes me energji elektrike të hidrovorit;
- b) skemat mekanike të pompave (sipas tipave të pompave);
- c) udhëzime mbi dhënien e ndihmës së parë për rastet e aksidenteve në punë;
- d) kutia e ndihmës së shpejtë.

12.3.13 Në sallën e elektropompave duhet të ketë impiant të ajrit të komprimuar, (kompresor ajri me pistoletë), i cili shërben për pastrimin e paneleve elektrike, elektropompave e nyjave të tjera. Pastrimi nga pluhuri dhe papastërtitë bëhet me fryrje ajri.

12.3.14 Në çdo elektropompë duhet të shënohet numri, sipas rendit të vendosjes së tyre në sallë.

12.3.15 Kanalet e kablove elektrike të shpërndarjes së energjisë elektrike, (transformator-panel elektrik-elektropompë), duhet të jenë të mbuluara e të lyera me ngjyrë të kuqe, si dhe të mbahen të pastra.

12.3.16 Në sallën e elektropompave, në një vend të caktuar, duhet të jenë:

- a) mjetet mbrojtëse sipas rregullave të sigurimit teknik;
- b) mjetet zjarrfikëse për pajisjet elektrike;
- c) mjetet e tjera izoluese si shtanga, indikatorë, dara, dorëza dhe galloshe dielektrike, të cilat nuk duhet të mbahen së bashku me instrumentet metalike, sepse mund të dëmtohet izolimi i tyre;
- d) numrat e telefonit për komunikim në raste të emergjencave me policinë, zjarr fikset, ndihmën mjeksore etj.

12.3.17 Ndalohet kategorikisht hyrja në hidrovor dhe rreth tij, të personave të jashtëm, pa autorizim nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit/NJPUKB.

12.4 Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e hidrovoreve

12.4.1 Rregulla të përgjithshme

a) Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, në zonën e tyre të kullimit, sigurojnë mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hidrovoreve, me qëllim garantimin e kullimit të tokave bujqësore për krijimin e kushteve të përshtatshme, kryesisht për aktivitetet bujqësorë.

b) Regjimet e punës të elektropompave të hidrovorit (sipas niveleve të ujit), miratohen nga drejtori i Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit/ drejtuesi i NJPUKB-së, në përputhje me projektin e skemës së kullimit dhe instruksionet e shfrytëzimit të elektropompave.

c) Hidrovoret, mbahen në gatishmëri teknike gjatë 24 orëve pa ndërprerje. Kur punonjësit e marrjes së ndërresës nuk paraqiten në punë, punonjësit, që duhet të lënë ndërresën, nuk mund të largohen nga puna pa u zëvendësuar. Lënia e hidrovorit, pa mbikëqyrje, ndalohet në mënyre kategorike dhe largimi nga vendi punës, pa u zëvendësuar, konsiderohet braktisje pune.

d) Gratë, që shërbejnë në hidrovor si punonjëse, duhet të vishen me pantallona, të jenë me bluze të kopsitur dhe me kapuç në kokë për mbledhjen e flokëve.

e) Të gjithë punonjësit e hidrovoreve, duhet të njohin mirë rregullat e dhënies së ndihmës së parë në rastet e goditjeve elektrike dhe aksidenteve të tjera në punë.

f) Gjatë remonteve vjetore, në rastet kur ngrihet elektropompa nga bazamenti i saj për kontroll, ose për të kryer punime të tjera, grupa që montohet elektropompa, të mbulohet me një skarë të sigurt, me qëllim ruajtjen e jetës së punonjësve.

g) Në rastet e përdorimit të pajisjeve portative (aparate saldimit, trapan, gur smeril etj.), për kryerjen e punimeve të ndryshme, duhet të merren më parë masat përkatëse për punë të sigurt me këtë pajisje elektrike dore.

12.4.2 Transformatorët e fuqisë

- a) Vendi i vendosjes së transformatorëve të brendshëm, duhet:
- i. të jetë me rrethim të sigurt, i mbrojtur nga shiu dhe lagështia dhe shënimet paralajmëruese “Ndal, rrezik vdekje”, “Tension i lartë”, “Mos prek” etj.;
 - ii. të ketë ajrim natyral, që siguron punën e transformatorit me ngarkesë nominale në çdo kohë të vitit;
 - iii. hapësirat ndërmjet transformatorit dhe mureve të dhomës, të jenë sipas përcaktimeve të kushteve teknike të montimit të transformatorit;
 - iv. pozicionimi i tyre të mos paraqes rrezik për personelin e shërbimit dhe të jetë i përshtatshëm për kontrollin e temperaturës, nivelit të vajit dhe marrjes së vajit për prova.
- b) Transformatorët duhet të kenë pasaportë teknike dhe target të vendosur mbi të.
- c) Transformatorët duhet jenë të tokëzuar.
- d) Mbingarkesa e transformatorit në regjimin normal nuk duhet të kalojë, vlerat e lejuar të përcaktuar në pasaportën teknike të transformatorit.
- e) Gjatë kontrollit të transformatorit të fuqisë duhet të këqyren ndër të tjera:
- i. niveli i vajit;
 - ii. ngjyra e vajit;
 - iii. rrjedhjet e vajit;
 - iv. temperatura e vajit;
 - v. gjendja e izolatorëve dhe e tokëzimit;
 - vi. dëgjohet zhurma e transformatorit gjatë punës.
- f) Kontrolli i transformatorit bëhet kur ai është i shkyçur. Në këtë kohë bëhet edhe pastrimi i transformatorit nga pluhuri dhe papastërtitë, shtrëngimi i bulonave dhe matja e rezistencës së izolimit të pështjellave etj.
- g) Në rastet kur transformatori shkyçet automatikisht, nën veprimin e mbrojtjes, kyçja në punë bëhet pasi të jetë eliminuar defekti për të cilin ndodhi shkyçja.
- h) Kur transformatori mbingarkohet, mbi normat e lejuara, punonjësit e ndërresës duhet të marrin masa përkatëse për t’ia hequr mbingarkesën.
- i) Transformatori duhet të shkyçet menjëherë kur vërehet ose dëgjohet:
- i. Zhurmë e fortë brenda në transformator;
 - ii. Rritje e temperaturës së transformatorit mbi normat e lejuara;
 - iii. Ndryshime të theksuara të ngjyrës së vajit;
 - iv. Thyerje ose çarje të izolatorëve, të cilët mund të bëhen burime shkarkimi ose avari të ndryshme.

12.4.3 Regjimet nominale të tensionit elektrik

- a) Ndalohet për çdo rast, marrja e energjisë elektrike për përdorues të tjerë të çdo kategorie, nga transformatorët e fuqisë së hidrovorit.
- b) Linjat e tensionit të mesëm apo të lartë, që furnizojnë me energji elektrike hidrovoret, duhet të jenë të zhveshura nga konsumatorë të tjerë publik apo privat.
- c) Ndryshimi i tensionit elektrik, që furnizon me energji elektrike elektropompat, të jetë brenda limiteve të lejuara, sipas pasaportave teknike të elektromotorëve.
- d) Ndryshimet e tensionit vërehen në voltmetrin kryesor, të vendosur në panelin elektrik të komandimit dhe nuk duhet të lejohet vazhdimi i punës me luhatje të tensionit jashtë kufijve të lejuar, pasi mund të dëmtohet elektromotori i pompës. Në këto raste punonjësi i hidrovorit kërkon ndihmën e personelit të shërbimit të nënstacionit elektrik, kur nuk ka mundësi të marre masa në kabinën e transformimit të hidrovorit.
- e) Dridhjet ose vibrimet e elektromotorëve gjatë punës, rekomandohet të mos kalojnë 0.1 mm për ato me shpejtësi rreth 1500 rrot/min dhe 0.16 mm për ato me shpejtësi më pak se 750 rrot/min.

12.4.4 Para se elektropompat e hidrovorit të futen në punë, duhet:

- a) të jenë prezent punonjësit e shfrytëzimit të ndërresës;

b) të jenë në pozicionin minimum (pa ngarkesë) lopatat e elektropompës, të cilat rregullohen me anën e mekanizmit të komandimit të këndit të lopatave (kur elektropompa është me lopata me kënd të rrotullueshëm);

c) sistemi i grasatimit të jetë vënë në punë 3–4 minuta para se elektropompa të lëshohet në punë;

d) të kontrollohet pozicioni i dorezës së rubinetit së qarkullimit të vajit të reduktorit;

e) të kontrollohen të gjitha nivelet e vajit të elektropompave;

f) niveli i ujit në thithje të mos jetë nën atë të lejuar;

g) të bëhet një rrotullim i plotë me dorë i elektropompës, pasi mund të jetë e bllokuar dhe më pas të bëhet lëshimi në punë;

h) skarat në seksionin e thithjes të mos jenë të bllokuara, të rrëzuara apo të prishura dhe nëpërmjet tyre të depërtojnë materiale të ngurta, të përmasave të mëdha, që mund të bllokojnë elektropompën;

i) të mos ketë prurje rëre me ujin në kanal in hyrës në sasi të konsiderueshme;

j) vaskat e elektropompave të jenë të pastruara;

12.4.5 Elektropompat e hidrovorit duhet të ndalojnë menjëherë punën, kur:

a) dëgjohen zhurma jonormale, që përsëriten;

b) tregimet e aparateve (ampermetër, voltmetër), kalojnë vlerat nominale;

c) kemi nxehje mbi normalen në nyjat përbërëse të agregatit;

d) kanali në hyrje të hidrovorit sjellë shumë masë të ngurtë;

12.4.6 Numri i elektropompave në punë duhet pakësuar, kur:

a) një ose disa nga elektropompat thithin ajër (dëgjohet zhurmë e mbytur në formë uturime me goditje);

b) shpejtësia e ujit në kanal, në hyrje të hidrovorit rritet shumë, uji turbullon dhe sjellë sasi të madhe rëre;

c) tensioni elektrik luhet përtej vlerave të lejuara dhe s'ka mundësi rregullimi në transformatorët e fuqisë.

12.4.7 Para mbarimit të çdo ndërrese, duhet të:

a) shikohen nivelet e vajit të kushinetave;

b) rrotullohen të gjithë grasatorët e kushinetave nga dy xhiro të plota;

c) pastrohen mirë nga mbetjet skarat e hidrovorit;

d) pastrohet salla dhe të gjithë agregatet e hidrovorit;

e) pastrohet dhe të vendosen në vendin e tyre veglat e punës;

f) pastrohet ambienti i jashtëm dhe të grumbullohen në vendin e caktuar papastërtitë, që nxirren nga skarat;

g) plotësohet dokumentacioni teknik i dorëzimit të ndërresës, siç përcaktohet në aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

12.4.8 Pas çdo jave pune, për çdo elektropompë:

a) kur qëndron pa punë disa ditë, lëshohet në punë 10 deri 15 minuta, që të mos depozitohet rërë në tabanin e vaskës së thithjes. Ky veprim është i domosdoshëm edhe për lubrifikimin e pjesëve të sipërme të reduktorëve;

b) të bëhet pastrimi i izolatorëve, zbarave, pajisjeve të lëshimit të tensionit të lartë e të ulët duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik;

c) të bëhet grasatimi i bokollave të pompës.

12.4.9 Pas çdo muaj pune, për çdo elektropompë të:

a) pastrohen mirë kontaktet e automateve në panelin e tensionit të ulët;

b) pastrohet gjithë pjesa e brendshme e panelit elektrik me ajër të komprimuar (kompresor);

c) grasatohen cernierat e të gjithë automateve, çelësave thikë në panelet e tensionit të ulët;

d) kontrollohen nyjat kryesore të pompës, mekanizmi i komandimit të lopatave, sistemet e grasatimit, vajtjes dhe ftohjes, reduktorët, kushinetat rrokullisëse dhe rrëshqitëse etj.

12.4.10 Për çdo elektropompë, nën mbikëqyrjen e inxhinierit mekanik/elektrik rekomandohet, që pas:

a) 1200 orë pune, të hiqet vaji i kushinetave dhe pasi të shpëlahen mirë, të mbushen përsëri me vaj të ri;

b) 1500 orë pune, të hiqet graso e kushinetave, që lubrifikohen me graso dhe pasi të pastrohen mirë nga grasua e vjetër, të mbushen përsëri në sasinë e kërkuar. Gjatë pastrimit dhe gratimit të kushinetave të elektromotorit, të bëhet kujdes, që të mos lagen pëstjellat e tij;

c) 3000 orë pune, të hiqet vaji i reduktorëve dhe pasi të pastrohen, mbushen përsëri me vaj të ri, deri në nivelin e duhur. Niveli përkatës duhet të kontrollohet gjatë punës.

12.4.11 Në stinën e verës të çdo viti, nën mbikëqyrjen e inxhinierit mekanik/elektrik, sipas gjendjes teknike të hidrovorit:

a) pastrohet vaska e thithjes së elektropompës dhe trupi i elektropompës;

b) bëhet remonti kapital i skarave të hidrovorit;

c) bëhet remonti kapital i të gjitha pajisjeve elektrike;

d) bëhet kontrolli dhe matja e rezistencës së tokëzimit;

e) hiqet elektromotori dhe reduktori dhe lubrifikohet nga sipër aksi i komandimit të lopatave me graso të shkrirë të përzier 20–30% me vaj lubrifikant;

f) ngrihet e gjithë elektropompa, hiqet difuzori i thithjes në formë kambane, hapet kapaku i mocos së helikës, pastrohen detalet e lëvizjes së lopatave, kontrollohet me imtësi mekanizmi i lëvizjes (fiksatorët), po ashtu edhe këmisha e kromuar e kapakut të mocos së helikës së bashku me kushinetën, që ndodhen në difuzior në formë kambane. Pasi sigurohemi se gjithçka është në rregull, mbyllet përsëri kapaku i mocos, duke e mbushur vetëm me graso rezistente ndaj ujit.

12.4.12 Pastrimi hidrovorit.

12.4.12.1 Dyshemeja duhet të pastrohet me ujë dhe detergjent në përshtatje me shtresën e dyshemesë, kurse pastrimi i sipërfaqes së jashtme të elektropompave dhe të panelit elektrik bëhet me solucion (përzierje uji dhe detergjenti sipas rastit konkret).

12.4.12.2 Panelet elektrike, pajisjet e brendshme të tyre, pastrohen me ajër të komprimuar me pistoletë, për shkak të prezencës së pluhurit, i cili nën efektin e nxehtësisë bëhet përcjellës i mirë i rrymës elektrike, për rrjedhojë krijon lidhje të shkurtra në pajisjet brenda tij. Po kështu duhet të pastrohen edhe elektropompat.

12.5 Remonti dhe kolaudimi vjetor teknik i hidrovorit

12.5.1 Për çdo hidrovor, kryhet remonti vjetor dhe në përfundim të tij bëhet kolaudimi teknik, i cili garanton vazhdimin normal dhe të sigurt të punës së hidrovorit, deri sa të bëhet remonti pasardhës.

12.5.2 Remonti zakonisht kryhet në periudhë të thatë pa reshje (zakonisht në muajt korrik dhe gusht) dhe duhet të përfundojë brenda muajit gusht (kryerja e ndërhyrjeve riparuese/rehabilituese të konstruksionit ndërtimor, të pajisjeve elektrike dhe mekanike të elektropompave dhe sistemit të lëshimit të tyre, si dhe e pajisjeve të tjera elektromekanike).

12.5.3 Kolaudimi vjetor teknik i hidrovoreve (testimi pa ngarkesë dhe me ngarkesë të plotë të elektropompave, pajisjeve elektrike, pajisjeve të pastrimit të skarave etj.), duhet të përfundojë brenda muajit shtator dhe të realizohet konform kërkesave të këtij udhëzimi dhe katalogëve teknik të elektropompave dhe pajisjeve elektrike.

12.5.4 Në kolaudim marrin pjesë drejtori të Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit/drejtuasi i NJPUKB-së, personat përgjegjës të stafit drejtues të DUK/NJPUKB (përfshirë stafin inxhinier mekanik/elektrik) dhe personeli i shfrytëzimit të hidrovorit.

12.5.5 Në përfundim, mbahet akti i kolaudimit i firmosur nga pjesëmarrësit në kolaudim dhe një kopje e tij dërgohet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/Bashki, brenda datës 10 tetor, shoqëruar me informacionin përkatës për sigurinë e punës së çdo elektropompe (përkrahë gjendja teknike e çdo elektropompe dhe shërbimet teknike të kryera gjatë remontit, si dhe konfirmohet garancia për vazhdimin normal të punës, deri në remontin e vitit pasardhës).

12.5.6 Shqyrtohen masat e marra për instruktimin e punonjësve të hidrovoreve mbi shfrytëzimin e pajisjeve elektromekanike sipas parametrave teknikë të lejuar dhe sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë (në kryerjen e punimeve mekanike dhe elektrike dhe manovrimeve përkatëse), sipas legjislacionit në fuqi, si dhe plotësimin të kushteve të punës për punonjësit e hidrovoreve.

12.5.7 Evidentohen mangësitë në furnizimin me energji elektrike të hidrovoreve (ndërprerjet e shpeshta, tensioni i ulët etj.), për arsye të defekteve të linjave të furnizimit me energji elektrike, dhe bërja prezent zyrtarisht, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), brenda muajit shtator.

12.6 Punimet kryesore gjatë remontit të hidrovorit

12.6.1 Për anën mekanike kanë të bëjnë kryesisht me:

- a) ngritjen (nëse është e nevojshme), të pompës nga bazamenti dhe kontrolli i saj;
- b) kontrollin e pjesëve/nyjave të konsumueshme (zëvendësimi i tyre sidomos i kushinetave, bokullave, gomina etj.);
- c) sistemin e grasatimit (pompat e grasos, tubacionet, zëvendësimi i atyre, që janë konsumuar/nuk funksionojnë dhe lidhja në skemën elektrike të lëshimit me elektropompën në mënyrë, që të garantohet kushti i futjes në punë të pompës së grasos, disa minuta para futjes në punë të elektropompës);
- d) sistemin e vaisjes;
- e) sistemin e komandimit të lopatave (garantimi i funksionimit të sigurt të nyjave dhe mekanizmave të tij);
- f) nivelin e vajit në kushineta;
- g) matësit e temperaturës së vajit;
- h) sistemin e ftohjes;
- i) nivelet e zhurmave dhe vibrimeve;
- j) skarat dhe pajisjet e pastrimit të tyre.

12.6.2 Për anën elektrike kanë të bëjnë kryesisht me:

- a) skemat e pajisjeve të lëshimit;
- b) skemat e mbrojtjes, çelësi me vaj etj.;
- c) izolacionin e elektromotorrit;
- d) tokëzimin dhe nulifikimin mbrojtës;
- e) skemën e matjes së energjisë (transformatorët e rrymës, kontaktorët);
- f) transformatorët e fuqisë, analizat dhe niveli i vajit në transformator;
- g) linjat e furnizimit me energji elektrike të tensionit të mesëm e të lartë;
- h) mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike, rrufepritësit;
- i) gjendjen teknike të linjave të furnizimit me energji elektrike dhe e pajisjeve të sigurisë dhe të transformimit të tensionit, konkretisht:
 - i. numri i linjave të furnizimit të hidrovorit dhe tensioni furnizues;
 - ii. numri i transformatorëve në punë dhe karakteristikat e tyre;
 - iii. numri i transformatorëve rezervë dhe karakteristikat e tyre;
 - iv. nevojat për transformatorë rezervë dhe karakteristikat e tyre;
- j) sigurimin e mjeteve të komunikimit (numrat dhe aparatet telefonik-mobil për sigurimin e komunikimit me personelin e shfrytëzimit të hidrovorit).

12.6.3 Masa të tjera që merren në hidrovor gjatë remontit:

- a) vendosjen në hidrovor të instrumenteve për matjen e nivelit të ujit në hyrje të hidrovorit dhe në funksion të saj, përcaktohen regjimet e punës së elektropompave (pozicioni i këndit të lopatave të pompave aksiale);
- b) vendosjen në hidrovor në një vend të përshtatshëm të aparateve për matjen e sasisë së reshjeve (aparat shimatës);
- c) kompletimin e hidrovoreve me personel shfrytëzimi të kualifikuar sipas strukturës së miratuar dhe sipas përcaktimeve në këtë udhëzim;

d) instruktimin e punonjësve të shfrytëzimit mbi sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë (në kryerjen e punimeve mekanike dhe elektrike), si dhe të plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas kërkesave të këtij udhëzimi;

e) sigurimin e bazës materiale të nevojshme rezervë dhe mjeteve të punës për kryerjen e shërbimeve të nevojshme në hidrovor;

f) sigurimin e lubrifikantëve, karburanteve dhe detergjenteve pastrues, për funksionimin normal të pajisjeve elektromekanike dhe mbajtjen pastër të ambienteve të punës;

12.6.4 Për periudhat me reshje, pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit/Bashkisë, të funksionojë grupi i emergjencës për të menaxhuar situatën dhe për të dhënë informacionet e duhura organeve eprorë në çdo kohë në lidhje me:

i. gatishmërinë teknike të hidrovoreve (numri i elektropompave në punë dhe jashtë pune);

ii. sasinë e reshjeve të rëna në milimetra (mm) për periudha të veçanta;

iii. nivelet e ujit në hyrje të çdo hidrovori dhe sipërfaqet e mbuluara me ujë sipas emërtimeve përkatëse të tyre;

iv. gjendjen e furnizimit me energji elektrike për çdo hidrovor (orët me energji dhe pa energji elektrike të hidrovoreve), si dhe vlerat e tensionit;

v. sasinë e ujit të larguar nga çdo hidrovor çdo 24 orë etj.

12.7 Dokumentacioni që mbahet në hidrovor

12.7.1 Në hidrovor mbahet:

a) Ky udhëzim dhe regjistrat sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, ku regjistrohen tregues të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së hidrovorit, si më poshtë:

1. Regjistri i Dorëzimit të Ndërresave (turneve);

2. Regjistri i Instruktimit për Sigurimin Teknik e Mbrojtjen në Punë për Punonjësit e Hidrovoreve;

3. Regjistri i Shërbimeve dhe Riparimeve të Defekteve;

4. Regjistri i Remonteve;

5. Regjistri i Aktkolaudimit;

6. Regjistri i Shfrytëzimit të Hidrovorit Ditor/Mujor/Vjetor;

7. Regjistri i Ndhmës së Shpejtë, Veglat dhe Pajisjet në Hidrovor;

8. Regjistri i Magazinës së Hidrovorit;

9. Regjistri i Kontakteve;

10. Regjistri i Shënimeve mbi Kontrollat në Hidrovor.

b) Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit;

c) Regjistrat e miratuar me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

d) Inventari fizik i pajisjeve e veglave të punës së hidrovorit;

e) Skemat elektrike, mekanike dhe katalogët e shfrytëzimit të elektropompave dhe nyjave të veçanta të hidrovorit;

f) Skema elektrike principale e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike e ekspozuar në një vend të dukshëm, që duhet të njihet nga punonjësit e shfrytëzimit.

12.7.2 Këto dokumente ruhen në hidrovor (si dhe në Drejtorinë e Ujitjes dhe të Kullimit/bashki), janë standarde dhe të sekretuara.

12.8 Veglat e punës dhe pajisjet që mbahen në hidrovor

12.8.1 Mjetet mbrojtëse kundra zjarrit.

12.8.2 Kutia e ndhmës së shpejtë.

12.8.3 Veglat, makineritë dhe pajisjet, (me të përdorshmet sipas eksperiencës së shfrytëzimit të hidrovoreve), në çdo kohë duhet të jenë të sistemuara në hidrovor për të mundësuar ndërhyrjet për kryerjen e shërbimeve/eliminimin e defekte apo në raste emergjencash.

12.8.4 Gardërobë për veshmbathjen e punës, tavolinë pune me karrige përballë panelit elektrik, për qëndrimin e personelit të shfrytëzimit, i cili vëzhgon gjatë gjithë kohës aparaturat në panel.

12.8.5 Veshmbathje për punonjësit e shfrytëzimit të hidrovorit dhe të pastrimit të skarave, të përshtatshme sipas kushteve konkrete të punës për të garantuar siguri në punë për punonjësit.

12.9 Magazina e hidrovorit

12.9.1 Magazina e hidrovorit duhet të jetë në çdo kohë e sistemuar dhe e pastër. Materialet të jenë të vendosura në rafte, të ndara, të sistemuara dhe të etiketuara.

12.9.2 Në magazinë mbahen (sipas eksperiencës në shfrytëzimin e hidrovoreve):

a) pjesë rezervë mekanike të elektropompës, si kushineta, bokulla, gomina, pompë grasoje, nyje të veçanta mekanike, bulloneri e rondele të dimensioneve të ndryshme;

b) pjesë rezervë të panelit elektrik si automat, bobina, transformatorë rryme, siguresa të tensionit të mesëm e të ulët, shkarkues, izolatorë, kablllo dhe përcjellës të dimensioneve të ndryshme;

c) veshmbathja për punonjësit;

d) transformatorë fuqie rezervë;

e) graso dhe vajra të ndryshëm;

f) vajguri dhe naftë për pastrim;

g) detergjente, sapun dhe peceta për pastrimin e pajisjeve elektromekanike dhe të sallës.

13. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e makinerisë së rëndë (ekskavatorë dhe draga) dhe mjeteve të transportit në administrim të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit dhe Bashkive, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes në objektet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja

13.1 Për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes nga vetë drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, në objektet e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të vepohet si më poshtë:

a) planifikimi i shpenzimeve operative për punimet e mirëmbajtjes së objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të realizohet duke ndjekur të njëjtën procedurë të parashikuar për planifikimin e investimeve;

b) propozimet në lidhje me pikën “a”, duhet të reflektojnë prioritetet e identifikuar edhe nga bashkëpunimi midis drejtorive të ujitjes dhe të kullimit dhe bashkive;

c) lista përfundimtare e objekteve për çdo drejtori të ujitjes dhe të kullimit, miratohet nga ministri, ndërsa për bashkitë nga Kryetari i Bashkisë;

d) për çdo objekt të miratuar sipas pikës “c” më lart, përpara fillimit të punimeve të zbatimit, duhet të bëhet azhurnimi i projektit të zbatimit me gjendjen faktike të objektit;

e) realizimi i të gjitha punimeve të mirëmbajtjes për objektet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, përfshirë këtu, detyrën e projektimit, hartimin e projektit të zbatimit, zbatimin e punimeve, si dhe mbikëqyrjen e kolaudimin, të bëhen në përputhje me legjislacionin për disiplinimin e punimeve të ndërtimit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

f) në planifikimin e kostove të punimeve të mirëmbajtjes, çmimi për 1 m³ (gërmim me ekskavator apo largim materiali të ngurtë me dragë), të llogaritet duke ju referuar kushteve konkrete të realizimit të punimeve për çdo objekt dhe gjendjes së makinerisë së rëndë. Analiza e çmimit për 1 m³ të shoqërohet me proces verbalin e kronometrimin të treguesve faktik, të harxhimit të karburantit, volumit të materialit të lëvizur në njësinë e kohës dhe zërave të tjerë të kostos;

g) drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, duhet të planifikojnë një rezervë karburanti të mjaftueshme për mbajtjen në punë të makinerisë së rëndë dhe mjeteve të transportit për një periudhë 2-javore, në rast emergjencash nga përmytjet e mundshme;

13.2 Për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e makinerisë së rëndë (ekskavatorë dhe draga) dhe mjeteve të transportit në administrim të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit dhe bashkive, të vepohet si më poshtë:

13.2.1 Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë janë përgjegjëse për përdorimin, shfrytëzimin dhe sigurimin teknik në punë të makinerisë së rëndë dhe mjeteve të transportit, të cilat kanë në administrim.

13.2.2 Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit/bashkitë, kryejnë mirëmbajtjen e nevojshme të makinerisë së rëndë dhe të mjeteve të transportit, për të siguruar gatishmërinë e lartë teknike të funksionimit të tyre për gjatë gjithë periudhës së vitit.

13.2.3 Gjatë përdorimit dhe shfrytëzimit të makinerisë së rëndë dhe të mjeteve të transportit (ekskavatorë, draga e automjete), të zbatohen kriteret si më poshtë:

a) përdoruesit e makinerisë së rëndë duhet të jenë të pajisur me leje manovrimi, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, si dhe rregullores së Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 1, datë 4.2.2004, “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”. Asnjë dokument tjetër nuk zëvendëson lejen e manovrimit;

b) përdoruesit e makinerisë së rëndë dhe përdoruesit e mjeteve të transportit, duhet të kenë njohuri të plota teknike mbi shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të rënda dhe të mjeteve të transportit sipas katalogëve teknik të shfrytëzimit dhe janë përgjegjës për dëmtimet dhe avaritë e shkaktuara nga keqpërdorimi i tyre;

c) përdoruesit e makinerisë së rëndë duhet të testohen mbi rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë për përdorimin, shfrytëzimin dhe transportin e makinerisë së rëndë, sipas legjislacionit në fuqi;

d) për punime në objekte të cilat paraqesin rreziqe për ndodhjen e aksidenteve (veçanërisht pranë zonave të banuara, nënlinjat e tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë, si dhe në toka të paqëndrueshme), përpara fillimit të punimeve duhet të merren masa për mënjanimin e aksidenteve;

e) për realizimin e punimeve sipas kushteve teknike të projektit të zbatimit, përdoruesit e makinerisë së rëndë duhet të jenë të pajisur me treguesit teknik të realizimit të punimeve. Gjithashtu, objekti ku punon makineria e rëndë duhet të jetë i pajisur me piketat orientuese;

f) çdo shërbim ose riparim, që i kryhet makinerisë së rëndë dhe mjeteve të transportit, duhet të shoqërohet me dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës, i cili duhet të përfshijë:

i. argumentimin teknik të kryerjes së shërbimit dhe/ose riparimit;

ii. përshkrimin e detajuar të shërbimit dhe/ose riparimit të kryer;

iii. situacionin e shpenzimeve për shërbimin dhe/ose riparimin e kryer;

g) dokumentacioni teknik i sipërcituar, sipas rastit, duhet të firmoset nga përdoruesi i makinerisë së rëndë dhe/ose drejtuesi i automjetit, si dhe nga personat përgjegjës të stafit drejtues të DUK/NJPUKB;

h) furnizimi me karburant, vaj dhe graso i makinerisë së rëndë dhe i mjeteve të transportit duhet të bëhet mbi bazën e dokumentacionin teknik përkatës, që përfshin objektin e punimeve (sipas projektit të zbatimit) apo destinacionin për mjetet e transportit.

i) për çdo furnizim të kryer për makinerinë e rëndë apo mjetin e transportit, duhet të firmosin përdoruesi i makinerisë së rëndë dhe/ose drejtuesi i automjetit, si dhe personat përgjegjës të stafit drejtues të DUK/NJPUKB;

j) dhënia në përdorim e makinerisë së rëndë përdoruesve, si dhe mjetet e transportit drejtuesve të tyre, të bëhet me proces verbal, ku të pasqyrohen detyrimet midis palëve.

k) për çdo makineri të rëndë apo mjet transporti, regjistrohen në mënyre dinamike (ditore, mujore, vjetore), treguesit teknik dhe ekonomik, siç përcaktohet në regjistrin përkatës të aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

13.3 Për lëvizjen e makinerisë së rëndë dhe mjeteve të transportit në administrim të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të veprohet si më poshtë:

a) lëvizja e makinerisë së rëndë dhe e mjeteve të transportit nga një drejtori ujitje dhe kullimi, e cila i ka në administrim, në një tjetër, për kryerjen atje të punimeve, bëhet me miratim të ministrit mbi bazën e kërkesës së drejtorisë së ujitjes dhe kullimit kërkues ose sipas nevojave, që paraqiten në situata emergjence;

b) lëvizja e makinerisë së rëndë dhe mjeteve të transportit për kryerjen e punimeve të subjekteve private apo shtetërore, bëhet vetëm me miratim të ministrit;

c) për marrjen e miratimit të lëvizjes së makinerisë së rëndë sipas pikës “a” (përjashtuar rastet e situatave emergjente) dhe pikës “b”, drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit duhet të paraqesin në ministri, një kërkesë të shoqëruar me:

1. kërkesën e subjektit privat apo shtetëror ose të drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit, drejtuar drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit, që ka mjetet në administrim, e cila duhet të përmbajë:

i. emërtimin e saktë të objektit ku do të realizohen punimet;

ii. përshkrimin e procesit të punës;

iii. tipin e makinerisë së rëndë që kërkohet;

iv. volumin e punimeve që do të realizohen (shoqëruar me projektin përkatës të objektit ku do të realizohen punimet);

v. periudhën e realizimit të punimeve.

2. Konfirmimin e drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit, për:

i. çmimin për 1 m³, shoqëruar me analizën e çmimit për 1 m³, referuar kushteve konkrete të realizimit të punimeve;

ii. totalin e ditëve të punës për realizimin e punimeve, si dhe periudhën e saktë të fillimit dhe të mbarimit të punimeve, duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për miratimin e kërkesës në ministri;

d) pas shqyrtimit, kërkesa për kryerjen e punimeve për llogari të subjekteve të tjera sipas pikave “a” dhe “b” më lart, i paraqet për miratim ministrit;

e) lidhja e kontratës ndërmjet drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit dhe subjekteve të tjera, bëhet vetëm pasi të jetë marrë më parë miratimi i ministrit. Kontrata duhet të përmbajë të gjithë elementët ligjore, teknikë e financiarë mbi kryerjen e punimeve;

f) në rast situatash të emergjencave civile, si përmytje, tërmet etj., kontrata e lidhur midis drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit dhe një subjekti tjetër, ndërpritet pa penalitete ndaj drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit. Ky kusht duhet të përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve;

g) për kryerjen e punimeve për subjektet e tjera private apo shtetërore, në llogaritjen e çmimit për 1 m³, të merren në konsideratë edhe elementë të tjerë të kostos si transporti i makinerisë së rëndë, dietat e manovratorëve etj. të cilat duhet të pasqyrohen në mënyrë analitike si pjesë përbërëse e çmimit për njësi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

ANEKS 1

1. Regjistri i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave të përdoruesve të ujit.

1.1 Regjistri i Drejtorive të Ujitjes dhe të Kullimit.

1.2 Regjistri i Bashkive.

1.3 Regjistri i Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU).

Aneksi 1

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- 1 Regjistri i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave të përdoruesve të ujit
- 1.1 Regjistri i Drejtorive të Ujitjes dhe të Kullimit

Nr.	Emri	Vendodhja	Zonat e Shërbimit	Personat e Kontaktit
1	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	Durrës	Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 1, të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtori: Tel: e-mail:
2	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Fier	Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 1, të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtori: Tel: e-mail:
3	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë	Korçë	Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 1, të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtori: Tel: e-mail:
4	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë	Lezhë	Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 1, të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Drejtori: Tel: e-mail:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Aneksi I

1 Regjistri i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave të përdoruesve të ujit

1.2 Regjistri i Bashkive

Nr.	Emërtimi i bashkisë	Vendodhja	Zonat e Shërbimit	Personat e Kontaktit
1			Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Kryetari..... Tel:
2			Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Kryetari..... Tel:

3			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>
4			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>

5			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>
6			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>

7			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>
8			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>

9			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>
10			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>

11			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>
12			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>

13			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>
14			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:</p> <p>Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:</p> <p>E-mail:</p>

15			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>
16			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>

17			<p>Siç përcaktohen në regjistrat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Aneksit 2 të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Kryetari..... Tel:..... Drejtori/Përgjegjësi për ujitjen dhe kullimin (emër-mbianëtar)..... Tel:..... E-mail:.....</p>
